

UNIVERSITY OF PRISHTINA
FACULTY OF PHILOLOGY

MA. Herolinda Bylykbashi

**Open Interrogative Clauses in English and Albanian
(Contrastive analysis)**

DOCTORAL THESIS

Prishtina, 2023

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I FILOLOGJISË

MA. Herolinda Bylykbashi

**Klauzat që përmbajnë pyetje të hapura në anglishten dhe
në shqipen (analizë kontrastive)**

PUNIMI I DOKTORATËS

Prishtinë, 2023

Summary

The doctoral thesis entitled “Open Interrogative Clauses in English and Albanian- (Contrastive analysis)” provides a basis for comparison concerning open interrogative clauses that function as main and subordinate clauses in English and Albanian. A description of open interrogative clauses in both languages reviewing past literature as well as a general theoretical panorama regarding the semanticity of interrogatives in both languages and the pragmatic functions (illocutionary forces) of questions in English and Albanian is provided, too.

Open interrogative clauses play a boundless role when it comes to clause types and the speech act performed when uttering this type of clause to ask a question. This doctoral thesis gives an account of open interrogative clauses functioning as main clauses and as subordinate clauses in English and Albanian, the structural differences and similarities of these clauses in both languages, the function of the *wh*-element in English and Albanian open interrogative clauses, the function of open interrogative content clauses (open interrogative clauses that function as subordinate clauses) regarding the previously mentioned languages, the frequency of *wh*-words used in both languages and translation differences when an open interrogative clause is translated from English to Albanian and vice versa.

Moreover, the doctoral thesis outlines differences and similarities of questions taking into consideration a semantic perspective and a pragmatic approach. A semantic analysis that analyzed types of questions in English and Albanian based on Huddleston et al.'s (2002) classification as well as a pragmatic analysis of questions in both languages is performed. The statistical data concerning open interrogative clauses in English and Albanian and types of questions are presented by using charts and in tabular form.

In order to be able to compare and contrast open interrogative clauses in both languages, the analysis is performed by taking into consideration written and spoken discourse concerning the corpus of the study. The data collection methodology of the written corpus includes two fiction books and one non-fiction book. The first book is George Orwell's “1984” translated into Albanian by Çelo Hoxha and the second one is Ismail Kadare's “Chronicle in Stone” translated into English by Arshi Pipa. On the other hand, when dealing with non-fiction books being part of the corpus, Richard Dawkins's “The God Delusion” translated into Albanian by Bardh Rugova is used. The

data collection analysis of the written corpus incorporates the identification of main and subordinate open interrogative clauses in the original version of the book followed by the corresponding translation for every open interrogative clause.

When dealing with the spoken corpus of the study, seven seven Meet the Press (NBC News) interviews (totaling 2 hours and 51 minutes) with the former President of the USA Donald Trump contribute to the English spoken corpus and two Rubikon (KTV) interviews (totaling 2 hours and 51 minutes) with the former President of the Republic of Kosova that are part of the Albanian spoken corpus. The English and Albanian interviews are transcribed based on Jefferson's system of transcription.

The study in hand consists of seven chapters and a description of each of them is going to be given below in order to have an idea concerning its structure.

The first chapter gives a theoretical description of clauses in both languages, the differences between main and subordinate clauses, clauses' classification in English and Albanian, the differences between finite and non-finite clauses, and verbless clauses.

The second chapter gives an account of open interrogative clauses in English as well as in Albanian. A theoretical description taking into consideration preliminary works in this field of expertise is given in order to distinguish between open interrogative clauses that function as main or subordinate clauses. This chapter also includes a theoretical description of interrogative words and phrases and their function within the open interrogative clauses as well as open interrogative content clauses and their function. A distinction between exclamative and open interrogative clauses is given in this chapter, too.

The third chapter includes the semantics of questions by defining the term question. It also gives a general panorama of kinds of question in English and Albanian, the differences between polar questions, variable questions, alternative questions, direction questions, biased questions, and echo questions. A theoretical description of interrogative tags and declarative questions is also provided as well as a traditional classification of questions.

The focal point of the fourth chapter is to provide a theoretical description concerning the term pragmatics, speech acts, direct and indirect speech acts, cooperative principle, and the set of maxims. The pragmatics of questions belongs to the last part of this chapter, too.

The fifth chapter incorporates a detailed syntactic analysis of open interrogative clauses functioning as main and subordinate clauses in English and Albanian. The analysis of open interrogative clauses consists of three parts. A comparison between both languages is drawn taking into account the structure of open interrogative clauses in both languages, the function of wh-element, the frequency of wh-words as well as the function of open interrogative content clauses in English and Albanian. The syntactic analysis is performed in open interrogative clauses extracted from two fiction books and one non-fiction book. The corpus includes open interrogative clauses extracted from George Orwell's "1984" original version and the translated version in Albanian by Çelo Hoxha, Ismail Kadare's "Chronicle in Stone" translated into English by Arshi Pipa, and Richard Dawkins's "The God Delusion" translated in Albanian by Bardh Rugova. The results of the conducted research are presented using charts.

The sixth chapter gives an account of questions in English and Albanian spoken discourse, more specifically political discourse. The analysis is divided into two parts, the first part deals with the semantic analysis of questions in English and Albanian, whereas the second part deals with the pragmatic analysis of questions in English and Albanian spoken discourse. To be able to perform semantic and pragmatic analysis, seven interviews of former USA President Donald Trump in Meet the Press (NBC News) are used as part of the English-spoken corpus, and two interviews of the former President of the Republic of Kosova Hashim Thaçi in Rubikon (KTV) are part of the Albanian spoken corpus. The results of the research are presented in tabular form and by giving a detailed argumentation when it comes to pragmatic analysis.

The seventh chapter provides concluding statements concerning open interrogative clauses in English and Albanian as well as gives a summary of differences and similarities between these languages based on the conducted research.

Keywords: *clause, main clause, subordinate clause, questions, semantics of questions, pragmatics of questions, contrastive analysis, English, Albanian.*

Rezime

Tema e doktoratës me titull “Klauzat që përmbajnë pyetje të hapura në anglishten dhe në shqipen (analizë kontrastive)” ofron një bazë për krahasim sa i përket fjalive pyetëse të hapura që funksionojnë si fjali kryesore dhe të nënrenditura në anglishten dhe në shqipen. Gjithashtu, jepet një përshkrim teorik i fjalive pyetëse të hapura në të dyja gjuhët, si dhe një vështrim i përgjithshëm teorik në lidhje me semanticitetin e pyetjeve në të dyja gjuhët dhe funksionet pragmatike (forcat ilokutive) të pyetjeve në anglishten dhe në shqipen.

Klauzat e pyetjeve të hapura luajnë një rol shumë të rëndësishëm kur bëhet fjalë për llojet e fjalive dhe aktet e të folurit që kryhen kur një fjali e tillë përdoret për të bërë një pyetje. Kjo tezë e doktoratës ka për qëllim të nxjerr përfundime me anë të analizimit të klauzave të fjalive pyetëse të hapura që funksionojnë si fjali kryesore dhe nënrenditëse në anglishten dhe në shqipen, ndryshimet në strukturë dhe ngjashmëritë e këtyre fjalive në të dyja gjuhët, funksionin e fjalëve pyetëse në këto klauza në anglishten dhe në shqipen, funksionin e klauzave të pyetjeve të hapura që funksionojnë si fjali të nënrenditura në të dyja gjuhët, shpeshtësinë e fjalëve pyetëse të përdorura në të dyja gjuhët dhe ndryshimet të cilat shfaqen si rrjedhojë e përkthimit të klauzave të pyetjeve të hapura prej anglishtes në shqipen dhe anasjelltas.

Për më tepër, kjo tezë e doktoratës i analizon pyetjet në të dyja gjuhët duke arritur në përfundime që kanë të bëjnë me dallimet dhe ngjashmëritë e pyetjeve duke marrë parasysh një këndvështrim semantik dhe një qasje pragmatike. Analiza semantike që ka për qëllim analizimin e llojeve të pyetjeve në anglishten dhe në shqipen është e bazuar në klasifikimin e Huddleston et al. (2002) si dhe është kryer një analizë e pyetjeve në të dyja gjuhët në aspektin pragmatik. Të dhënat statistikore në lidhje me klauzat e pyetjeve të hapura në anglishten dhe në shqipen dhe llojet e pyetjeve janë paraqitur duke përdorur grafikët dhe në formë tabelare.

Korpusi i vjelur me qëllim të krahasimit dhe kontrastimit të klauzave të pyetjeve të hapura në anglishten dhe në shqipen përfshinë diskursin e shkruar dhe atë të folur. Metodologjia e mbledhjes së të dhënave të korpusit të gjuhës së shkruar përfshinë dy libra artistik (fiction) dhe një libër joartistik (non-fiction). Libri i parë është romani “1984” i George Orwell-it i përkthyer në shqipen nga Çelo Hoxha, libri i dyti është romani “Kronikë në gur” i Ismail Kadaresë i cili është përkthyer në anglishten nga Arshi Pipa. Në anën tjetër, sa përket librave joartistik (non-fiction) të përdorur

si korpus i këtij studimi është zgjedhur libri “The God Delusion” i Richard Dawkins, i përkthyer në shqipen nga Bardh Rugova. Analiza e mbledhjes së të dhënave të korpusit të gjuhës së shkruar përbëhet nga identifikimi i klauzave të pyetjeve të hapura që funksionojnë si fjali kryesore dhe nënrenditëse në versionin original të secilit libër dhe identifikimi i përkthimit përkatës të secilës kaluzë të pyetjeve të hapura.

Sa i përket korpusit të diskursit të folur, shtatë intervista (2 orë e 51 minuta) të ish-Presidentit të SHBA-së Donald Trump në Meet the Press (NBC News) janë pjesë e korpusit të folur në anglishten dhe dy intervista (2 orë e 51 minuta) të ish-Presidentit të Republikës së Kosovës Hashim Thaçi në Rubikon (KTV) janë pjesë e korpusit të folur të shqipes. Intervistat në anglishten dhe në shqipen janë transkriptuar bazuar në sistemin e transkriptimit të Jeffersonit.

Studimi në fjalë përbëhet nga shtatë kapituj dhe një përshkrim i secilit prej tyre do të jepet më poshtë për të pasur një ide në lidhje me strukturën e tij.

Në kapitullin e parë është dhënë një përshkrim teorik i klauzave në të dyja gjuhët, i ndryshimeve midis klauzave kryesore dhe të nënrenditura, i klasifikimit të klauzave në anglishten dhe në shqipen, i ndryshimeve midis klauzave me formë të shtjelluar dhe të pashtjelluar të foljes si dhe i klauzave të paplota (verbless clauses).

Kapitulli i dytë i shtjellon në rrafshin teorik klauzat e pyetjeve të hapura në anglishten dhe në shqipen. Një vështrim teorik duke marrë në konsideratë studimet paraprake në këtë fushë të studimit është dhënë për të bërë dallimin ndërmjet klauzave të pyetjeve të hapura që funksionojnë si fjali kryesore ose të nënrenditua. Ky kapitull përfshinë gjithashtu një përshkrim teorik të fjalëve dhe frazave pyetëse dhe funksionin e tyre brenda klauzave të pyetjeve të hapura që funksionojnë si fjali kryesore si dhe funksionin e klauzat të pyetjeve të hapura që funksionojnë si fjali nënrenditëse. Po ashtu, dallimi në mes të klauzave të pyetjeve të hapura dhe klauzave nxitëse (exclamative) përfshihet në këtë kapitull.

Në kapitullin e tretë është dhënë një përshkrim teorik për semantikën e pyetjeve duke përcaktuar termin pyetje. Po ashtu, një vështrim i përgjithshëm teorik i llojeve të pyetjeve në anglishten dhe në shqipen, i ndryshimeve midis pyetjeve polare, pyetjeve të ndryshueshme, pyetjeve alternative, pyetjeve të drejtimit, pyetjeve të njëanshme dhe pyetjeve me jehonë (echo) është dhënë në këtë kapitull.

Një përshkrim teorik në lidhje me termin pragmatikë, aktet e të folurit, aktet e të të folurit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, parimin bashkëpunues (cooperative principle) dhe grupin e maksimave janë dhënë në kapitullin e katërt. Në pjesën e fundit të këtij kapitulli shtjellohen pyetjet në aspektin pragmatik.

Kapitulli i pestë përmban një analizë të detajuar sintaksore të klauzave të pyetjeve të hapura që funksionojnë si fjali kryesore dhe të nënrenditura në anglishten dhe në shqipen. Analiza e klauzave të pyetjeve të hapura përbëhet nga tri pjesë. Krahasimi midis dy gjuhëve është bërë duke marrë parasysh strukturën e klauzave të pyetjeve të hapura në të dyja gjuhët, funksionin e fjalëve pyetëse, shpeshësinë e fjalëve pyetëse si dhe funksionin e klauzave të pyetjeve të hapura që funksionojnë si klauza nënrenditëse në anglishten dhe shqipen. Analiza sintaksore është kryer në klauzat e pyetjeve të hapura të vjela nga dy libra artistik (fiction) dhe një libër joartistik (non-fiction). Korpusi përfshinë klauzat e pyetjeve të hapura të nxjerra nga versionet origjinale të romaneve “1984” të George Orwell dhe nga versioni i përkthyer në shqipen nga Çelo Hoxha, “Kronikë në gur” i Ismail Kadarese i përkthyer në anglishten nga Arshi Pipa dhe “The God Delusion” i Richard Dawkins përkthyer në shqipen nga Bardh Rugova. Rezultatet e hulumtimit të kryer janë paraqitur me anë të grafikëve.

Në kapitullin e gjashtë analizohen pyetjet në diskursin e folur në anglishten dhe në shqipen, më konkretisht në diskursin politik. Analiza është e ndarë në dy pjesë, pjesa e parë ka të bëjë me analizën semantike të pyetjeve në anglishten dhe në shqipen, ndërsa pjesa e dytë merret me analizën pragmatike të pyetjeve në diskursin e folur në anglishten dhe në shqipen. Në mënyrë që të analizohen pyetjet e diskursit të folur në aspektin semantik dhe pragmatik, janë përdorur shtatë intervista të ish-presidentit të SHBA-së Donald Trump në Meet the Press (NBC News) si pjesë e korpusit të folur të anglishtes dhe dy intervista të ish-Presidentit të Republikës së Kosova Hashim Thaçi në Rubikon (KTV) janë pjesë e korpusit të folur të shqipes. Rezultatet e hulumtimit janë paraqitur në formë tabelare dhe duke dhënë një argumentim të detajuar kur bëhet fjalë për analizën pragmatike.

Kapitulli i shtatë përmban argumentet përmblylëse në lidhje me klauzat e pyetjeve të hapura në anglishten dhe shqipen, si dhe bën një përmbledhje të dallimeve dhe ngjashmërive ndërmjet këtyre gjuhëve bazuar në hulumtimin e kryer.

Fjalët kyçe: *klauzë, klauzë kryesore, klauzë nënrenditëse, pyetjet, semantika e pyetjeve, prgmatika e pyetjeve, analizë kontastive (krahasuese), gjuha angleze, gjuha shqipe.*